

VENDIM
Nr.61, datë 13.9.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË OSSH SHA
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË VITIT 2011

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 10 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSSH sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, konstatoi se:

Aplikimi i OSSH sh.a. për planin e investimeve për vitin 2011 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të OSSH sh.a. për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta